

## KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027 BASHKIA FIER

Përballja e Ofertave Politike (POP) është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Fier, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra Rinore “Epoka e Re”, e cila që prej vitit 2006 funksionon si organizatë jo-fitimprurëse me seli në Fier, por me shtrirje aktiviteti në të gjithë Shqipërinë.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale. Hartimi i saj vjen pas një kalendari aktivitetesh të paracaktuara përpara nisjes së fushatës elektorale, duke u bazuar në praktikat si: fokus grupe, takime të drejtpërdrejta me qytetarët, takime me grupe të ndryshme interesi. Vlerësimi individual i çdo personi, pjesëmarrës në këto takime ka nxjerrë në pah prioritetet kryesore, të cilat u strukturuan në këtë kontratë.

Kontrata sociale 2023-2027 prezantohet gjatë periudhës së fushatës elektorale të të gjithë kandidatët për kryetar bashkie. Pas këtij momenti dhe dakordësisë me ta, me zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë, kjo kontratë merr vlerë dhe do të jetë një dokument i vlefshëm për 4 vitet e ardhshme, progresi i së cilës do të monitorohet nga Qendra “Epoka e Re”.

### PRIORITETET KRYESORE

**Prioriteti nr. 1 - Strategji komunikimi, si domosdoshmëri për forcimin e demokracisë në nivel vendor, në shërbim të avancimit të agjendës së integrimit evropian.**

- Faqe interneti lehtësisht e aksesueshme për çdo qytetar dhe e përditësuar me të gjitha informacionet e nevojshme.
- Krijimi i një strategjie të re në shpërndarjen e informacionit, kryesisht për ato që lidhen ngushtë me interesat e qytetarëve, ndikimin në jetën e tyre (si: programet e ndryshme të nxitjes së punësimit, biznesit, strehimit etj).
- Vendosja e këndeve informuese (info points) të digjitalizuara në pika strategjike të qytetit, me qëllim informimin e qytetarëve, kryesisht vizitorëve vendas dhe të huaj.

**Prioriteti nr. 2 - Këshillim dhe bashkëqeverisje me Komunitetin.**

- Fuqizimi i Këshillit Vendor Rinor, Këshillit Vendor të Sigurisë Publike dhe ndikimi i tyre në politikat vendore.
- Nxitje e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse dhe hartuese përmes një procesi të hapur dhe transparent.

- Fuqizimi i mekanizmave komunitarë si mënyra më e mirë e organizimit të qytetarëve për një qeverisje më të mirë (ndërlidhësi komunitar, këshillat komunitarë & kryepleqtë e fshatrave).

### **Prioriteti nr. 3 - Mbështetje për të rinjtë, për të ardhmen e qytetit tonë.**

- Plan Lokal Veprimi për Rininë mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.
- Programe konkrete për nxitjen e punësimit dhe mbështetjen e bizneseve startup rinore si një mundësi për punësimin e të rinjve, me qëllim evitimin e largimit të tyre nga vendi.
- Hapja dhe funksionimi i zyrës së edukimit të karrierës në mjediset e Bibliotekës “Dritëro Agolli” Fier, për të mbështetur edukimin e të rinjve në moshë të hershme.
- Shtirja e aktiviteteve rinore edhe në njësitë administrative nëpërmjet vendosjes në funksion të hapësirave rinore të sigurta, sipas standardit (referuar Ligjit për Rininë 75/2019).
- Konkretizimi i iniciativës për hapjen e një Universiteti në Fier.

### **Prioriteti nr. 4 – Terrene Sportive në shkolla dhe ambiente publike.**

- Standardizim, rehabilitim i palestrave dhe terreneve sportive në të gjitha shkollat, kryesisht në shkollat: “Mark Dashi”, “Perikli Ikonomi” (terreni jashtë), “Vasil Sota” Verri, “Nazif Zhavari” Kafaraj, “Mustafa Hoxha” Cakran.
- Shtim i terreneve sportive jo vetëm në shkolla, por edhe në lagjet e qytetit dhe njësitë administrative.

### **Prioriteti nr. 5 - Ngritja e Qendrave Komunitare me shërbime të integruara për grupet vulnerabël.**

- Ndërtimi i një qendre psiko-sociale për viktimat e dhunës në familje dhe grupet në nevojë.
- Vënia në funksion e qendrës komunitare Seman.
- Krijimi i hapësirave për qendra komunitare në të gjitha zonat rurale, si e vetmja mundësi integrimi dhe socializimi.

### **Prioriteti nr. 6 - Transport publik cilësor dhe i përbalueshëm.**

- Ndërtimi i stacioneve të dedikuara, unifikuara dhe standardizuara, si dhe afishimi i orareve në çdo stacion në qytet dhe njësi administrative.
- Shtimi i orarit të shërbimit të transportit deri në orën 18:00 në të gjitha linjat drejt Njësive Administrative.
- Ofrimi i shërbimit të transportit publik në qytet.

### **Prioriteti nr. 7 - Urbanizimi i zonave informale, për të plotësuar hartën e një qyteti me zhvillim të qëndrueshëm.**

- Urbanizimi i zonave informale Afrim – Mbrostar Ferko.
- Përfundimi i unazës së qytetit për të lehtësuar trafikun në qytet.
- Mbulimi 100% i qytetit me kanalizime të ujërave të bardha dhe të zeza (KUZ).
- Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe formalizimi i plotë i monitorimit të konsumit të tij (plotësimi me matësa për të evituar abuzimet me konsumin e ujit dhe faturat afrofe).

#### **Prioriteti nr. 8 - Ndalimi i ndotjes mjedisore nga lëndët hidro-karbure në lumin Gjanica.**

- Investimi asnjëherë nuk do të ketë vlerë pa eliminimin e problemit më jetik për banorët siç është ndotja. Eliminimi i ndotjes së ujit të lumit nga lëndët kimike dhe hidrokarburet është një emergjencë.

#### **Prioriteti nr. 9 - Rikonstruksioni i plotë i rrugës Fier – Seman.**

- Rruga Fier – Seman, një rrugë që t'u shërbejë automjeteve, këmbësorëve, lëvizjes me biçikleta (me trotuare dhe korsi biçikletash).

#### **Prioriteti nr. 10 - Rehabilitimi dhe krijimi i kushteve optimale në të gjitha shkollat, kopshtet dhe çerdhet.**

- Rikonstruksion i plotë/ rindërtim i shkollave: “Llazar Dashi” Sheq i Madh, “Naim Frashëri”, “Liri Gero”, Gjimnazi “Kutbi Vrushaj” Levan.
- Rikonstruksion i plotë i shkollave në Njësitë Administrative: “Mustafa Hoxha” Cakran, “Tefik Dautaj” Varibop, “Halit Grëmi” Mbrostar Ura, “Nazif Zhavari” Kafaraj, Fermë Çlirim, “Baftjar Luzati” Radostinë.
- Funksionimi i shkollave si qendra komunitare pas orarit të mësimt, në formën e një bashkëpunimi mes ZVA, Bashkisë dhe OJF-ve.
- Ndërtim i 2 kopshteve të reja në qytet, me të gjitha kushtet e nevojshme, për të ulur numrin e fëmijëve që frekuentojnë këto institucione dhe rritur standardin.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan